

Prishtinë 10/08/2005

Udhëzimi i Përkohshëm I_02_2005 mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin Ngrohës 2005/2006

KAPITULLI 1 Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Në përputhje me Nenin 18 të Ligjit Nr. 2004/8 mbi Energjinë, dhe Nenet 15, 26 dhe 47 të Ligjit Nr. 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë nxjerr Udhëzimin e Përkohshëm mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006 (“Udhëzimi”).

Neni 2 Qëllimi

- 2.1 Ky Udhëzim përcakton procedurat dhe parimet për paraqitjen e aplikacionit të tarifave, llogaritjen dhe aprovimin e tarifave dhe çmimeve të ngrohjes në sektorin e rregulluar të ngrohjes qendrore, për sezonin e ngrohjes 2005/2006.
- 2.2 Termat e përdorur në këtë Udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim si në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë.

KAPITULLI 2 Procedurat për Paraqitje dhe Aprovim të Tarifave dhe Çmimeve

Neni 3 Fillimi i Procedurës

Gjer me 1 shtator 2005, sipas Shtojcës Nr. 2 të Udhëzimit të Përkohshëm I_01_2005 “Mbi Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore”, ndërmarrja e ngrohjes qendrore i paraqet Zyrës së Rregullatorit të Energjisë një aplikacionin me shkrim për aprovim të tarifave dhe çmimeve të ngrohjes për sezonin e ngrohjes 2005/2006.

Neni 4

Verifikimi i Aplikacionit

- 4.1 Në rast se aplikacioni përputhet me dispozitat e këtij Udhëzimi, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të shqyrtojë të gjitha të dhënat e renditura në aplikacion si dhe dokumentet përkatës të bashkangjitur.
- 4.2 Zyra e Rregullatorit të Energjisë mund të verifikojë me iniciativën e vet, rrethanat e përmendura dhe të dhënat, dhe mund të kontaktojë ndërmarrjet e ngrohjes si dhe të kërkojë dokumente ose informacione shtesë. Ndërmarrjet e ngrohjes qendrore do të sigurojnë këto dokumente dhe informacione për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë brenda afateve përfundimtare të përmendur në Nenin 5 të këtij Udhëzimi.

Neni 5

Ekzaminimi Formal

- 5.1 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike prej marrjes së aplikacionit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, do të ekzaminojë aplikacionin e paraqitur, dhe dokumentet e kërkuara të bashkangjitura.
- 5.2 Nëse aplikacioni dhe të gjitha dokumentet e kërkuar, nuk janë në përputhje me kushtet e këtij Udhëzimi, ose në rast se të gjithë dokumentet e kërkuar nuk janë të bashkangjitur, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, do të njoftoj aplikantin. Njoftimi me shkrim do të ftojë aplikantin të korrigjojë aplikimin e tij brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike prej datës së njoftimit.
- 5.3 Në rast se aplikanti dështon të korrigjojë mospërputhshmërinë e aplikacionit të tij, ose të bashkëngjit dokumentet e kërkuara, brenda periudhës së përcaktuar në Nenin 5.2, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të refuzojë aplikimin dhe do të njoftojë aplikantin me shkrim. Njoftimi do të dërgohet tek aplikantin brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike prej datës së përcaktuar në Nenin 5.2.
- 5.4. Në rast se Zyra e Rregullatorit të Energjisë e refuzon aplikimin sipas Nenit 5.3, kjo Zyrë do të vendosë gjoba në përputhje me Nenin 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, deri në përmbushjen e kushteve të përcaktuara në Nenin 5.2, dhe do të vendosë tarifën e ngrohjes bazuar në informacionet ekzistuese dhe sipas vlerësimit të vet më të mirë.

Neni 6

Propozimi për Tarifën dhe Çmimet

- 6.1 Në aplikacion, ndërmarrjet e ngrohjes qendrore do të përfshijnë propozimin e tyre për tarifën dhe çmimet e sezonit të ngrohjes, i cili zyrtarisht fillon më 15 tetor 2005 dhe përfundon më 15 prill 2006.
- 6.2 Propozimi do të përfshijë tarifën dhe çmim(et) për ngrohjen e dërguar tek konsumatorët e fundit (finalë).

Neni 7 Përmbajtja e Aplikacionit

- 7.1 Aplikacioni për aprovim e tarifave dhe çmimeve të ngrohjes do të specifikojë:
- emrin i aplikantit, adresën e zyrës kryesore, emrin i personit kontaktues, certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe numrin i regjistrimit të tatimit së aplikantit;
 - propozimin dhe justifikimin e plotë për tarifën dhe çmimet e kërkuara (propozimi do të paraqitet pasi Zyra e Rregullatorit të Energjisë të ketë përcaktuar të ardhurat e lejueshme vjetore për ndërmarrjen e ngrohjes qendrore);
 - aplikimi duhet të nënshkruhet prej personit të autorizuar që përfaqëson aplikantin.
- 7.2. Së bashku me aplikacionin, aplikanti duhet të paraqesë në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dokumentet vijuese:
- pasqyrat (raportet) vjetore financiare (pasqyrën e të ardhurave, bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë) për vitin e kaluar, me dokumentin e bashkangjitur:
 - raportin e auditorit nëse pasqyrat vjetore financiare të aplikantit ka qenë subjekt i auditimit të pavarur financiar;
 - përshkrim i detajuar i fondeve në dispozicion dhe/ose burimet e financimit për kryerjen e aktivitetit të energjisë, dhe dëshmia e vlefshmërisë së këtyre fondeve/burimeve të financimit;
 - llogaritje të detajuara, evidenca dhe justifikime për llogaritjet e çdo elementi në veçanti të tarifave dhe çmimeve, në përputhje me kërkesat e këtij Udhëzimi. (llogaritjet e detajuara do të paraqiten pasi Zyra e Rregullatorit të Energjisë të ketë përcaktuar të ardhurat e lejuara vjetore për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore);
 - informacione në lidhje me të ardhurat vjetore të parashikuara prej shitjeve të ngrohjes tek konsumatorët e fundit, kostot totale të parashikuara të prodhimit, distribuimit dhe furnizimit të ngrohjes, plani investues (nëse ka) dhe rrjedhjen e parasë të parashikuar (pasqyra e të hyrave e parashikuar, bilanci i gjendjes i parashikuar dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë e parashikuar), kapaciteti total i kontraktuar i ngrohjes, dhe prodhimi vjetor total i ngrohjes i parashikuar në MWh – ky informacion duhet të mbulojë periudhën prej 15 tetor 2005 deri më 15 tetor 2006; dhe
 - Listën e të gjithë dokumenteve të paraqitur.
- 7.3. Nëse aplikanti ka për qëllim të zbatojë një projekt afatgjatë investimi, përveç dokumenteve të specifikuar në Nenin 7.2, duhet të paraqesë:
- modelin financiar për periudhën e projektit;
 - përshkrimin e parametrave të rëndësishëm të modelit financiar;
 - marrëveshjen e nënshkruar e cila drejton zbatimin e projektit dhe parimet e vënies së çmimeve (nëse ka);
 - justifikim të plotë për arsyet e një investimi të tillë.

Neni 8

Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara

- 8.1 Bazuar në informacionin e aplikimit, siç përcaktohet në Nenin 7 të këtij Udhëzimi, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të llogarisë dhe përcaktojë të ardhurat e lejuara për ndërmarrjen e caktuar të ngrohjes qendrore.
- 8.2 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do t'i komunikojë me shkrim, ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, vlerën e të ardhurave të lejuara për sezonin ngrohës 2005/2006, brenda 15 ditëve kalendrike pas marrjes së aplikacionit (pjesës së aplikacionit që përmban informacionin që përcaktohet në Nenin 7.2, pikat "a", "b", "d")
- 8.3 Gjatë përcaktimit të të ardhurave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2005/2006, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të marrë në konsideratë bashkërendimin e tarifës së tanishme (sezoni i ngrohjes 2004/2005) dhe tarifës së projektuar (për sezonin e ngrohjes 2005/2006) ashtu që norma ekuivalente e kthimit për çdo sezon të jetë e njëjtë (siç është lejuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë). Bashkërendimi do të bazohet në ndryshimin e të ardhurave vjetore të projektuara dhe atyre reale që rezultojnë midis kostove të projektuara dhe atyre reale të sezonit të mëparshëm ngrohës.

Neni 9

Shqyrtimi dhe Aprovimi i Tarifave dhe Çmimeve

- 9.1 Bazuar në të ardhurat e lejuara, që janë përcaktuar sipas Nenit 8, ndërmarrjet e ngrohjes qendrore do të paraqesin në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë propozimin e tarifave së bashku me llogaritjet e detajuara, siç përcaktohet në Nenin 7.1, pika "b" dhe 7.2, pika "c"; propozimi i tarifave dhe llogaritjet e detajuara do të paraqiten brenda 15 ditëve kalendrike pas marrjes së të ardhurave të lejuara siç janë përcaktuar.
- 9.2 Pas verifikimit dhe ekzaminimit të aplikimit për tarifën dhe çmimet, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të vendosë si vijon:
 - a) ose të aprovojë tarifën dhe çmimet siç janë propozuar nga ndërmarrja e ngrohjes qendrore; ose
 - b) Të refuzojë aprovimin e tarifave dhe çmimeve të propozuar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, dhe në vend të kësaj, të vendosë vetë tarifën dhe çmimet për sezonin ngrohës 2005 / 2006, sipas metodologjisë së përmendur në Nenin 11 dhe 12.
- 9.3 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të refuzojë aprovimin e këtyre tarifave dhe çmimeve të propozuar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, në rast se ato nuk janë në përputhje me parimet e llogaritjes së tarifave të përcaktuar në Nenin 16 / Shtojca 2 e këtij Udhëzimi
- 9.4 Refuzimi do të justifikohet me shkrim dhe do të jetë objektiv, jo-diskriminues dhe i dëshmuar.
- 9.5 Vendimi në lidhje me tarifën dhe çmimet prej Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, do të përmbajë një shtojcë me shpjegime analitike të procesit të shqyrtimit dhe aprovimit, si dhe justifikimin për një vendim të tillë.

- 9.6 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të marrë vendimin në lidhje me aplikimin për aprovimin e tarifave dhe çmimeve, brenda 45 ditëve prej datës së pranimit të aplikacionit, ose prej datës së korigjimit të aplikacionit për arsye të mospërputhshmërisë. Vendimi, në formë të shtypur, do t'i dorëzohet aplikantit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, dhe gjithashtu do të botohet (pa shtojcën e përmendur në 9.5) në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Neni 10

Propozimi për ndryshim të tarifave dhe çmimeve

- 10.1 Gjatë sezonit të ngrohjes 2005/2006, ndërmarrja e ngrohjes qendrore ka të drejtë t'i paraqesë Zyrës së Rregullatorit të Energjisë propozimin për ndryshime në tarifat e aprovuara. Ky propozim duhet të justifikohet dhe të përfshijë të gjitha të dhënat e nevojshme që ZRRë ta vlerësoj propozimin.
- 10.2 Propozimi për ndryshime në tarifa mund të paraqitet në rastet e ndryshimeve në legjislacionin përkatës, ndryshimeve brenda ndërmarrjes që ndikojnë në shpenzime, ose në rastet kur ka ndryshime të rëndësishme të çmimit të karburantit, ose ndonjë shkak tjetër që është jashtë kontrollit të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore.
- 10.3 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të shqyrtojë, modifikojë ose refuzojë propozimin në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim.

KAPITULLI 3

Metodologjia e Tarifave

Neni 11

Metodologjia e Aplikuar e Tarifave

- 11.1 Për qëllim të formulimit të tarifave dhe çmimeve për sezonin e ngrohjes 2005/2006, do të aplikohet metodologjia e normës së kthimit (RoR) (ose e ashtuquajtura "kosto plus"). Kjo metodologji përcakton kostot e lejuara që duhen mbuluar, dhe profitin (fitimin) e arsyeshëm që do të fitohet nga ndërmarrja e ngrohjes qendrore, e cila llogaritet nga norma e lejuar e kthimit në bazën e rregulluar të asetëve (RAB).
- 11.2 Në përputhje me parimet e metodologjisë RoR, ndërmarrja e ngrohjes qendrore ka të drejtë që të rikthejë kostot e veta të justifikuara dhe normën e lejuar të kthimit në bazën e rregulluar të asetëve.

Neni 12

Formulimi i Metodologjisë Tarifore të Normës së Kthimit

- 12.1 Formulimi i metodologjisë të normës së kthimit është bazuar në të ardhurat e lejuara vjetore totale, që përbëhet nga kostot operacionale që janë të "justifikueshme",

zhvlerësimi dhe kthimi i lejueshëm në bazën e rregulluar të asetëve, që mund të përfshijë koston e asetëve të reja. Kjo është llogaritur me formulën:

$$R = OC + \text{Zhvlerësimi} + [\text{RoR} \times (\text{RAB} - \text{Zhvlerësimi})]$$

Ku :	
R	Të ardhurat e lejuara në total
OC	Kostot e lejuara operacionale
RoR	Norma e Kthimit e lejuar nga ZRRë
RAB	Baza e Rregulluar e Asetëve

- 12.2 Kostot e lejuara operacionale janë të përbëra nga pjesa fikse dhe ajo variabile, sipas formulës:

$$OC = OC_F + OC_V$$

Ku:	
OC _F	Pjesa fikse e kostove operacionale
OC _V	Pjesa variabile e kostove operacionale

- 12.3 Zhvlerësimi në investimet ka karakter fikse dhe do të bëhet në përputhje me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës (SKK) dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2002/3.
- 12.4 Norma e kthimit e lejuar në bazën e rregulluar të asetëve (RAB) minus Zhvlerësimi, rezulton në një profit (fitim) të lejuar për ndërmarrjen e ngrohjes qendrore, dhe konsiderohet të jetë komponent fikse. Formula është:

$$\text{Profiti i Lejuar} = \text{RoR} \times [\text{RAB} - \text{Zhvlerësimi}]$$

- 12.5 Llogaritja e RoR të lejuar do të jetë Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit (WACC), prej së cilës do të llogaritet kthimi i vlerësuar i kërkuar prej investitorëve, në kontekst të Modelit të vlerësimit të asetëve kapitale (CAPM). Për arsye informimi dhe përputhshmërie, formulat përcaktuese të llogaritjeve të WACC janë paraqitur në Shtojcën 1 të këtij Udhëzimi.
- 12.6 Është në kompetencë të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë që të vendosë RoR-in ose WACC e lejuar të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore.
- 12.7 Baza e rregulluar e asetëve (RAB) përfaqëson asetet e ndërmarrjes të konsideruara për t'u përdorur dhe që janë të dobishme në shërbimin publik. Shpenzimet e reja kapitale (Capex) mund të inkorporohen në RAB, kur të planifikohet dhe aprovohet nga ZRRë.

Neni 13 Shpjegimet për Llogaritjen e Tarifave

- 13.1 Tarifat për sezonin ngrohës 2005/2006 do të përmbajnë 2 lloje të veçanta të tarifave:

- A. Tarifa për Konsumatorë të pa-njehsuar, e quajtur tarifa normative, bazuar në konsumin e vlerësuar të ngrohjes për metër katror. Kjo tarifë do të aplikohet për ata konsumatorë që janë të lidhur me pikat e dërgimit (nënstacionet), ku nuk është implementuar ende njehsimi (matja e konsumit) i ngrohjes; dhe
- B. Tarifa për konsumatorë të njehsuar, bazuar në konsumin e vërtetë të ngrohjes, të matur në pikën e dërgimit. Kjo tarifë mund të aplikohet ndaj atyre konsumatorëve që janë të lidhur me pikat e dërgimit (nënstacionet), ku njehsimi e ngrohjes është i implementuar dhe faturimi do të kryhet në mënyrë të rregullt.
- 13.2 Tarifa e përmendur në Nenin 13.1 pika B do të propozohet prej ndërmarrjes së ngrohjes për çdo konsumator ku është implementuar njehsimi i ngrohjes, dhe do të hyjë në fuqi pas pranimit me shkrim nga konsumatori.
- 13.3 Çdo lloj tarife do të përmbajë 2 komponentë:
- a) fiks, e lidhur me kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes – shprehur në [€/ m²] për konsumatorët e pa-njehsuar, dhe në [€/ kW] për konsumatorët e njehsuar; dhe
 - b) variabile, e lidhur me ngrohjen e dërguar tek konsumatorët – e shprehur në [€/ m²] për konsumatorët e pa-njehsuar, dhe në [€/ kWh] për konsumatorët e njehsuar.
- 13.4 Komponenti fiks i tarifës, do të llogaritet në bazë të komponentit fiks të të ardhurave të lejuara.
- 13.5 Komponenti variabil i tarifës do të llogaritet në bazë të komponentit variabil të të ardhurave të lejuara.

Neni 14

Ndarja e Konsumatorëve në Grupe Tarifore

- 14.1 Ndarja e konsumatorëve në disa grupe tarifore, do të bëhet vetëm nëse justifikohet prej dallimeve në shpenzime në kurriz të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore për t'u dërguar ngrohjen, sipas kriterëve vijuese:
- a) burimet e prodhimit të ngrohjes që furnizojnë rrjetin e ngrohjes qendrore;
 - b) rrjeti i ngrohjes qendrore që distribuon ngrohjen;
 - c) vendi dhe lloji i ndërtesës (godinës) së konsumatorit ku dërgohet ngrohja, si dhe sasia dhe kualiteti i duhur i furnizimit; dhe
 - d) kërkesat e konsumatorëve në lidhje me sigurinë dhe vazhdimësinë e furnizimit me ngrohje.

Neni 15

Përcaktimi dhe Alokimi i të Ardhurave të Lejuara

- 15.1 Të ardhurat e lejuara siç përcaktohet në Nenin 12.1, do të jenë bazë për llogaritjen e tarifave dhe çmimeve të ngrohjes.
- 15.2 Duke marrë për bazë karakteristikat e komponenteve përbërës, të ardhurat e lejuara do të përbëhen prej komponentit fiks dhe variabil, i cili formulohet si vijon:

$$R = R_F + R_V$$

- 15.3 Kostot e lejueshme operacionale përfaqësojnë kostot totale vjetore të parashikuara dhe të justifikueshme, të cilat ndërmarrja lejohet që ti rikthej, dhe të cilat do të përfshijnë:
- Koston e burimeve të energjisë primare (karburantet),
 - Koston e energjisë së konsumuar (elektriciteti),
 - Koston e ujit të përgatitur të konsumuar
 - Kostot e personelit – pagat plus kontributet për pension dhe taksa të tjera të pagueshme prej kompanisë,
 - Koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes së sistemit,
 - Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin e ngrohjes qendrore, siç është blerja e disa shërbimeve prej kontraktorëve të jashtëm, etj. Dhe
 - Kostot e jashtëzakonshme të justifikuara..
- 15.4 Kostot e lejueshme operacionale nuk do të përfshijnë:
- subvencionet,
 - kostot e refuzuara prej autoriteteve tatimore,
 - kostot e lënies mënjane dhe zhblokimit të rezervave,
 - pagesat e qerasë për vlerën e artikujve që nuk mbahen në regjistrin e llogaritar, dhe
 - kostot financiare dhe kostot tjera të jashtëzakonshme.
- 15.5 Në përputhje me Nenin 12.2, kostot e lejueshme operacionale përbëhen nga pjesa fikse dhe ajo variabile ($OC = OC_F + OC_V$); ndarja e kostove operacionale në fikse dhe variabile do të bëhet prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore në përputhje me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës.
- 15.6 Për llogaritjen e tarifave, OC_F dhe OC_V duhet të alokohen, përkatësisht në R_F dhe R_V .
- 15.7 Në përputhje me Nenin 12.3, zhvlerësimi është llogaritur në bazën e rregulluar të aseteve, dhe konsiderohet komponentë fikse.
- 15.8 Për llogaritjen e tarifave, zhvlerësimi alokohet në komponentin fiks të të ardhurave të lejuara (R_F).
- 15.9 Në përputhje me Nenin 12.4, kthimi në bazë e aseteve përfaqëson profitin e lejuar, dhe konsiderohet komponentë fikse.
- 15.10 Për llogaritjen e tarifave profiti i lejuar alokohet në komponentin fiks të të ardhurave të lejuara (R_F).
- 15.11 Si pasojë, komponenti fiks përkatësisht komponenti variabil i të ardhurave të lejuara do të formulohet si vijon:
- Komponenti fiks i të ardhurave të lejuara (R_F) përbëhet nga pjesa fikse e kostos së lejuar operacionale, zhvlerësimi dhe profiti i lejuar, sipas formulës vijuese:

$$R_F = OC_F + \text{Zhvlerësimi} + [RoR \times (RAB - \text{Zhvlerësimi})]$$

- b) Komponenti variabil i të ardhurave të lejuara (R_V), përbëhet nga pjesa variabile e kostove të lejuara operacionale:

$$R_V = OC_V$$

Neni 16 Detajet për Llogaritjen e Tarifave

- 16.1 Detajet për llogaritjen e tarifave paraqiten në Shtojcën 2 të këtij Udhëzimi.

Neni 17 Çmimet ndaj Konsumatorëve dhe Faturimi

- 17.1 Fatura e ndërmarrjes së ngrohjes qendrore do i dërgohet konsumatorëve, të lidhur në rrjetin e distribuimit të ngrohjes, në baza mujore gjatë gjashtë muajve të sezonit të ngrohjes.

- 17.2 Çdo faturë do të detalizon çmimin total si vijon:

A. Për konsumatorët e pa-njehsuar:

- a) Rata (vlera) e pagesës mujore për kapacitetin ngrohës të kontraktuar (komponenti fiks), llogaritet si tarifa mujore fikse për metër katrore shprehur në [€m^2] e shumëzuar me hapësirën ngrohëse të konsumatorit e shprehur në [m^2]; dhe
- b) Rata (vlera) e pagesës mujore për ngrohjen e dërguar (komponenti variabil, e faturuar për çdo muaj që është dërguar ngrohja, që llogaritet si tarifa mujore variabile për metër katror e shprehur në [€m^2] e shumëzuar me hapësirën ngrohëse të konsumatorit, e shprehur në [m^2].

B. Për konsumatorët e njehsuar:

- a) Rata (vlera) e pagesës mujore për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenti fiks), që llogaritet si kapaciteti i kontraktuar i matur në [kW], i shumëzuar me tarifën mujore të kapacitetit të kontraktuar, të shprehur në [€kW]; dhe
- b) Rata (vlera) e pagesës mujore për ngrohjen e dërguar (komponenti variabil), e faturuar për çdo muaj që është dërguar ngrohja, që llogaritet si ngrohja e furnizuar e njehsuar, e matur në [kWh], e shumëzuar me tarifën për ngrohjen e dërguar, e shprehur në [€kWh].

KAPITULLI 4

Dispozitat Përfundimtare

Neni 18

Hetimet

- 18.1 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të drejtojë hetime të rregullta, me qëllim të:
- a) vlerësimit të informacionit të raportuar dhe të vlerësuar financiar të paraqitur prej ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore;
 - b) verifikimit të shpenzimeve aktuale përgjatë periudhës rregullative, në përputhje me legjislacionin ekzistues mbi financat dhe kontabilitetin (Standardet e Kontabilitetit të Kosovës; dhe
 - c) përcaktimin e të ardhurave për periudhën rregullative.

Neni 19

Gjuha dhe hyrja në Fuqi

- 19.1. Aplikacioni dhe të gjitha dokumentet që i paraqiten Zyrës së Rregullatorit të Energjisë duhet të jenë në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës.
- 19.2. Ky Udhëzim do të aplikohet menjëherë pasi të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Në emër të ZRrE
Dr. Nick F. Frydas
Kryesues i Bordit